



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POLIÇAN  
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_Prot

Data, 02.07.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNE PUBLIKE**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i Procedurës:**

"Mbrojtje lumore gjatesore e tokave bujqesore nga lumi Osum, fshati Vodice, Polican "

**Kodi Përkatës**

**në Fjalorin e Përbashkët**

**të Prokurimit (CPV):** Punime argjinature 45243510-0

**Vlera e Fondit Limit:** 80 133 019 ( tetedhjetë milion e njeqind e tridhjetë e tre mijë e nentëmbëdhjetë leke ) pa TVSH.

Burimi i financimit:nga buxheti i shtetit me cikël financimi 2024-2025. Vlera e financimit për vitin 2024 është 42 783 993 (dyzetë e dy milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nentëdhjetë e tre) leke pa tvsh dhe Vlera e financimit për vitin 2025 është 37 349 026(tridhjetë e shtatë milion e treqind e dyzetë e nente mijë e njetëzete e gjashtë) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin 16/2024 nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021" *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", autoriteti kontraktor **Bashkia Poliçan** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

*a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; I ZBATUESHEM*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar , nenit 26 dhe nenit 29, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (Shtojcat).

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të nenit 3 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

Vendosja e këtyre kriterëve behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara me poshte, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

**2.2.2** Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

**2.2.3** Operatoret Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për kesten e maturuar të vitit 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nën 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore .

*Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nën 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar si dhe Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**2.3.1/a** Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Faturat tatimore;
5. Akt Kolaudimi
6. Certifikatën e Marrjes në dorezim të punimeve

**2.3.1/b** Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Fatura tatimore;
4. Akt Kolaudimi

## 5. Certifikaten e Marrjes ne dorezim te punimeve

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin 16/2024 në nenin 47, dhe 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme në një objekt të vetëm të jenë minimalisht në vlerat 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar, ose për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rëndesinë e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion, tipologjinë e punimeve të ndërtimit si edhe mbështetur në LPP dhe në RRPP. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon dokumentacionin si më sipër.

**2.3.2** Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**2.3.2** Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

### **PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI**

**NP-1 A** Punime gërmimi në tokë.

**NP-9 C** Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime

**NP-12 B** Punime të inxhinierisë mjedisore

### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

**NS-18 B** Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas projekt idese.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas projektit dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Detajini i kërkeses se cdo license sipas punimeve qe do te kryhen:

NP-1 A Punime gërmimi në tokë.

Nr.	Nr . AN	Pershkrimi I Punimeve	Njesi	SASI	ÇMIMI	VLERA
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	9027		
6	3.88/b	Germim me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi	m3	6500		

NP-9 C Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime

Nr.	Nr . AN	Pershkrimi I Punimeve	Njesi	SASI	ÇMIMI	VLERA
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	9027		

2	3.235+an	Struktura monolite betoni C 16/20 me 20% gur	m3	2030		
3	3.352	Mbushje me gur kave per skoliere	m3	9258		
4	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	4320		
5	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar 1x1x1.5 m	m3	2020		
6	3.88/b	Germim me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi	m3	6500		
7	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	1		
	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	3200		
<b>SHUMA</b>						

**NP-12 B Punime të inxhinierisë mjedisore**

<b>Nr.</b>	<b>Nr . AN</b>	<b>Pershkrimi I Punimeve</b>	<b>Njesi</b>	<b>SASI</b>	<b>ÇMIMI</b>	<b>VLERA</b>
3	3.352	Mbushje me gur kave per skoliere	m3	9258		
4	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	4320		
5	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar 1x1x1.5 m	m3	2020		

**NS-18 B Punime topogjeodezike.**

<b>Nr.</b>	<b>Nr . AN</b>	<b>Pershkrimi I Punimeve</b>	<b>Njesi</b>	<b>SASI</b>	<b>ÇMIMI</b>	<b>VLERA</b>
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	9027		
2	3.235+an	Struktura monolite betoni C 16/20 me 20% gur	m3	2030		
5	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar 1x1x1.5 m	m3	2020		
6	3.88/b	Germim me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi	m3	6500		

**2.3.3** Operatoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 72 ( shtatedhjetë e dy ) personave të siguruar për periudhen e tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, afati i realizimit të kontratës, orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për të paktën tre muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Numri i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në zbatim të tij.

#### DETAJIMI SIPAS OREVE TE PUNES

Nr.	Nr . AN	Pershkrimi i Punimeve	Njesi	SASI	ORE PUNE	ORE PUNE TOTAL	DITE PUNE
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	9,027	0.11	983.94	123
2	3.235+an	Struktura monolite betoni C 16/20 me 20% gur	m3	2,030	10.80	21,924.00	2,741
3	3.352	Mbushje me gur kave per skoliere	m3	9,258	3.40	31,477.20	3,935
4	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	4,320	0.04	172.80	22

5	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar 1x1x1.5 m	m3	2,020	5.30	10,706.00	1,338
6	3.88/b	Germim me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi	m3	6,500	0.15	1,001.00	125
7	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	1	61.00	61.00	8
8	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	3,200	0.08	256.00	32
<b>SHUMA</b>							<b>8322.7</b>
<b>Afati i realizimitsipas grafikut 6 muaj (132 dit pune)</b>							<b>132</b>
<b>Numri total i puntoreve</b>							<b>63</b>
<b>Staf teknik (drejtues teknik 4 + inxhinier teknik 5 )</b>							<b>9</b>
<b>Totali nr. Punonjesve</b>							<b>72</b>

**2.3.4** Operatoret Ekonomike duhet te kene pjese te stafit teknik te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise si me poshte:

- a. Inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknik **1 (nje)**
- b. Inxhinier Mjedisi **1 (nje)**
- c. Inxhinier Gjeodet **1 (nje)**
- d. Inxhinier Hidroteknik **1 (nje)**

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise se minimalisht per periudhen e tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projekt idene ne ternat e references, volume e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, inxhinier mjedisi, gjeodet , hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e



nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas projekt idese si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-iden duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në projekt ide.

Ne kete procedure jane kerkuar keta drejtues qe te fuigurojne ne licensen e shoqerise pasi objekti lidhet ngushte me keto profesione. Mbrojtja Lumore ka punime topogjezike te ndryshme, punime per devijime lumre, prerence uji ne te gjitha punimet, punimet e ketij objekti lidhen ngushte me mjedisin perreth, dhe te gjitha punimet nentokesore e tjera e beje te domosdoshme kerkesen per keta 4 drejtues teknik.

**2.3.5** Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- Ing. Ndertimi 1 (nje)
- Teknik Ndertimi 1 (nje)
- Teknik Topograf 1 (nje)
- Teknik Gjeolog 1 (nje)
- Teknik Hidroteknik 1 (nje)
- Karpentier 12 (dymbedhjete)
- Specialist Guri/Gurepunues 10 (dhjete)
- Murator 5 (pese)
- Saldator 1 (nje)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Automakinistë 2 (dy)
- Manovrator 5 (pese)
- Buldozieristë 2 (dy)
- Specialist Ndertimi 6 (gjashte)
- Hidraulike 1 (nje)
- Shofer 4 (kater)
- Puntori e thjeshte 13(trembedhjete)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Certifikate e Aftësisë Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit .

Për Manovratore/automakiniste/ shofer të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR . Në rastin kur punonjësit e mesiperm janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht për mjetet e marra me qira , nuk kërkohej të figurojnë në listepagesat e shoqërisë.

Dokumentacioni (Diplomat/deshmte/certifikatat) që nuk është lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një listë personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informaticën dhe manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” bazuar në përlogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtesisht me listën e stafit teknik të kerkuar nga AK , si edhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt të objektit.

- Ing. Ndertimi 1 (nje)
- Teknik Ndertimi 1 (nje)
- Teknik Topograf 1 (nje)

- Teknik Gjeolog 1 (nje)
- Teknik Hidroteknik 1 (nje)

Inxhinieri i ndertimit dhe Teknikat jane kerkuar per ndjekjen e punimeve te ndryshme ne kantier. Inxhinieri i ndertimit do te kryej oragnizimin e punimeve te zbatimit me tekniket e tjere. Tekniku i ndertimit me orientimin e proceseve te punimeve te ndertimit te ndryshme sipas grafikut te punimeve, tekniku topograf me zbatimin e detyrave dhe piketave te percaktuara nga ing. Topograf, tekniku gjeolog per ndjekjen e punimeve te germimit dhe klasifikimi i llojit te shtresave dhe dheut sipas germimeve qe kerkohen te kryhen ne projekt, tekniku hidroteknik per punimet te cilat kane lidhje me ujerat siperfaqesor (lumi) apo ujerat nentokesore si pasoje e germimeve dhe ndjekja e tyre deri ne zbatimin sipas projektit teknik.

- Karpentier 12 (dymbedhjete)  
Per punimet e ndryshme sipas preventivit zeri me 2,3
- Specialist Guri/Gurepunues 10 (dhjete)  
Per punimet e ndryshme sipas preventivit zeri me 5
- Murator 5 (pese)  
Per punimet e ndryshme sipas preventivit zeri me 5,3
- Saldator 1 (nje)
- Hekurkthyes 2 (dy)  
Per punimet e ndryshme sipas preventivit zeri me 5,7
- Automakinistë 2 (dy)
- Manovrator 5 (pese)
- Buldozieristë 2 (dy)
- Specialist Ndertimi 6 (gjashte)
- Hidraulike 1 (nje)
- Shofer 4 (kater)
- Puntori e thjeshte 13 (trembedhjete)

Per punimet e ndryshme sipas preventivit zeri me 1,3,4,6,8

**2.3.6** Operatoret Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te pakten:

**2.3.6/a** -1 (nje) punonjes te pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10237, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome dhe certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën e tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit

**2.3.6/b** Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për

ushttrimin individual të profesionit, diplomë. Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licenca përkatëse ,si dhe faturen e këtij shërbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 , dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç” VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projekt idene në ternat e references, volume e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas projekt idese si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-iden duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuar ne projekt ide.

### 2.3.7 Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	në pronësi ose me qira	cope	6
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	në pronësi ose me qira	cope	2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 1.5 deri ne 2 ton	në pronësi ose me qira	cope	2
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton	në pronësi ose me qira	cope	2
5	Eskavator me goma ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	3
6	Eskavator me zinxhir me krahe mbi 18m	në pronësi ose me qira	cope	1
7	Fadrome me goma ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	1
8	Minifadrome ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	1

9	Damper ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	2
10	Grejder ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	1
11	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	cope	2
12	Autobot Uji	në pronësi ose me qira	cope	2
13	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	cope	6
14	Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 14 ton	në pronësi ose me qira	cope	1
15	Autopompe Betoni	në pronësi ose me qira	cope	2
16	Vibrator Betoni	në pronësi ose me qira	cope	4
17	Autobetoniere me kapacitet 2.5-3.5m3( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	1
18	GPS	në pronësi ose me qira	cope	1
19	Kontinier Stacioner (zyra, ndrresa)	në pronësi ose me qira	cope	1
20	Buldozer	në pronësi ose me qira	cope	2
21	Koke terheqese	në pronësi ose me qira	cope	1
22	Betoforma	në pronësi ose me qira	m 2	200
23	Kokore	në pronësi ose me qira	Copë	72
24	Jelek	në pronësi ose me qira	Copë	72

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë**, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases/ bashkëpunimit.
- **Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë**, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d”

të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore ipas zërave përkatës të detyres se projektimit. Mjetet jane percaktuar sipas nevojës se zbatimit te projektit si me poshte:

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të detyres se projektimit. Mjetet jane percaktuar sipas nevojës se zbatimit te projektit si me poshte:

1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	në pronësi ose me qira	cope	6
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	në pronësi ose me qira	cope	2

Keta kamiona jane te domosdoshem pasi sipas preventivit kemi punimet zeri nr.2,3,3,5,8.

3	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 1.5 deri ne 2 ton	në pronësi ose me qira	cope	2
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton	në pronësi ose me qira	cope	2

Keto mjete do te nevojiten per te sjell ne kantier materialet e lehta dhe vegla pune nga me te ndryshme ne kantier,po ashtu do te bejne te mundur dhe transportimin e stafit se bashku me puntoret cdo dite nga kantieri.

Eskavator me goma ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	3
Eskavator me zinxhir me krahe mbi 18m	në pronësi ose me qira	cope	1
Fadrome me goma ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	1
Minifadrome ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	1
Damper ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	2
Grejder ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	1
Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 14 ton	në pronësi ose me qira	cope	1
Buldozer	në pronësi ose me qira	cope	2

Keto mjete do te sherbejne per kryerjen e germimeve te ndryshme sipas projektit.Po ashtu me keto mjete do te behet hapja dhe sistemimi i cakullit dhe shtreave perkatese sipas projektit, kryhet levizja e materialeve brenda kantierit,krijimi i argjinaturave, kryerjen e mbushjeve sipas projektit etj...

21	Koke terheqese	në pronësi ose me qira	cope	1
11	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	cope	2

Keto mjete do te sherbejne per trasportin e mjeteve te renda ne kantier te cilat nuk levizin ne rruge si : eskavatoret me zinxhira, grejderi,fadroma, ruli hekur gome etj...

12	Autobot Uji	në pronësi ose me qira	cope	2
----	-------------	------------------------	------	---

Per furnizimin ne kantier me uje

13	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	cope	6
14	Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 14 ton	në pronësi ose me qira	cope	1
15	Autopompe Betoni	në pronësi ose me qira	cope	2
16	Vibrator Betoni	në pronësi ose me qira	cope	4
17	Autobetoniere me kapacitet 2.5-3m3( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	cope	1

Keto mjete do te sherbejn per sjelljen e betonit per shtresat e ndryshme te planifikuara ne project, per dergimin e betonit ne zona te ndryshme dhe ne lartesi te ndryshme nepermjet autopompes se betonit dhe Vibratori ik betonit do te kryej procesin e vibrimit dhe berjen sa me kompakt sipas kushteve teknike betonin e kerkuar ne kantier.Ndersa ruli do te sherbej per ngjeshje e shtresave te ndryshme sipas analizave teknike perkatese

18	GPS	në pronësi ose me qira	cope	1
----	-----	------------------------	------	---

Per piketimet ne onjekt sipas projektit te zbatimit

19	Kontinier Stacioner (zyra, ndrresa)	në pronësi ose me qira	cope	1
----	-------------------------------------	------------------------	------	---

Per zyre inxhinierat tekniket etj,,

22	Betoforma	në pronësi ose me qira	m 2	200
----	-----------	------------------------	-----	-----

Armatura do te nevoitet per punimet e betonimet sipas specifikimeve te ndryshme ne projekt.

23	Kokore	në pronësi ose me qira	Copë	72
24	Jelek	në pronësi ose me qira	Copë	72

Kushtet teknike ne objekt

### 2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:

- Licence e leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77 dhe 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 39 dhe 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi,

i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”, *Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”*. Nga punimet e ndertimit do të gjenerohen mbetje që duhen transportuar në vendepozitim të caktuar nga AK.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkëpunimi impiantet si me poshte vijon:

a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) .Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit, është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/bashkëpunimit e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve .

**Argumentim:** *Per garantimin e cilesise dhe furnizimit ne kohe sipas te gjitha specifikimeve qe jane kerkuar nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.10** Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015**, mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.

**Argumentim:** *Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 44/1 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: „Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.



Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## **ANETARET E NJESISE SE PROKURIMIT**